

BULETINI INFORMATIV

NËNTOR

2025



Gjatë muajit nëntor, ERE ka vijuar ushtrimin e veprimtarisë së saj rregullatore dhe vendimmarrëse në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror. Në këtë përmbledhje mujore do të gjeni informacion mbi mbledhjet e Bordit, licencimet e reja, publikimet, të dhënat e tregut, çmimet e shitjes së energjisë si dhe dokumentet që ndodhen në proces konsultimi publik. Synimi ynë mbetet garantimi i transparencës, rritja e eficiencës dhe mbështetja e zhvillimit të tregut të energjisë në vend. Për më shumë detaje, vendimet dhe dokumentet e plota mund t'i shfletoni në faqen tonë zyrtare: www.ere.gov.al

Vendimmarrjet e Bordit të ERE gjatë muajit nëntor

Gjatë muajit nëntor 2025, Bordi i ERE ka zhvilluar 4 mbledhje vendimmarrëse. Në këto mbledhje u shqyrtuan dhe miratuan 30 vendime, që përfshijnë: licencime të reja për centrale prodhuese, rinovime dhe njohje licencash ekzistuese; fillimin e procedurave të reja të licencimit; autorizime; miratimin e akteve rregullatore dhe udhëzuesve teknikë; vendime mbi çmimet dhe tarifat e energjisë; si dhe fillimin e procedurave rregullatore të cilat aktualisht janë objekt i konsultimit publik. Vendimet e plota gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ERE-s në kategorinë [vendimet](#).

Gjatë muajit nëntor janë licencuar përkatësisht shoqëritë:

- **“Infotelecom-Albsolar 4” shpk** në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 35.6 MW, me vendndodhje në Qarkun Dibër. Ky central pritet të vihet në operim brenda datës 01.10.2026.
- **“IDI 2005” shpk** në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet prodhues 8.8 MW, me vendndodhje në Qarkun Fier. Ky central pritet të vihet në operim brenda datës 25.09.2028.
- **“NIKOLICA SKI RESORT” shpk** në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali eolik, me kapacitet të instaluar 3MW, me vendndodhje në Qarkun Vlorë. Ky central pritet të vihet në operim brenda datës 13.04.2026.
- **“SPITALLA SOLAR” shpk** në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 90MW, me vendndodhje në Qarkun Durrës. Ky central pritet të vihet në operim brenda datës 31.12.2027.

Gjithashtu ERE ka rinovuar licencën e shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” shpk në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 17.04.2026; si dhe ka dhënë miratimin e saj për njohjen e licencës për tregtimin e energjisë elektrike, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës (ZRRE), për shoqërinë “INTERENERGO D.O.O. – KOSOVA” shpk. Afati i njohjes së kësaj licence do të jetë i njëjtë me afatin e licencës së lëshuar nga ZRRE, deri më 27.02.2027.

BULETINI INFORMATIV

NËNTOR

2025



Gjatë muajit nëntor, janë filluar procedurat licencimit për shoqëritë:

- **“BUSHTRICA 2017” shpk** në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Bushtrica 2”, me kapacitet të instaluar 4.800 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë, në Qarkun e Elbasanit.
- **“ELENERGJI” shpk** në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Bushtrica 1”, me kapacitet të instaluar 5,226 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë, në Qarkun e Elbasanit.

Për këto vendime janë njoftuar shoqëritë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Gjithashtu në përputhje me “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, për aplikimet e mësipërme ERE ka publikuar në median e shkruar, në faqen zyrtare www.ere.gov.al si dhe në rrjetet sociale Instagram, Facebook dhe LinkedIn, njoftimin për marrjen e objeksioneve para vendimmarrjes respektive të licencimit ose jo.

Autorizime për garanci financiare

Bordi i ERE-s miratoi kërkesën për marrjen e autorizimit për vendosjen e kuotave me qëllim garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj palës kredidhënëse “First Investment Bank” sh.a., për shoqërinë “Klos Torrent Works” sh.p.k (Ish-“MALIDO-ENERGJI” shpk), licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 78, datë 23.10.2009, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Klos” me kapacitet prodhimi 1.519 kW.

Po ashtu, Bordi i ERE-s miratoi kërkesën për miratim për ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, për shoqërinë “PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k, licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 06.06.2023 në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe me vendimin e Bordit të ERE-s nr 188, datë 06.06.2023 në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Për këto vendime janë njoftuar shoqëritë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Pas çdo vendimmarrjeje është përditësuar regjistri përkatës i autorizimeve dhe është publikuar në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

Vendime të tjera

U miratua dokumenti i përbashkët i tre Rregullatorëve të Energjisë, ERE, RAAEY(Greqi) dhe ARERA (Itali) mbi miratimin e një ndryshimi të “Kodit të Rrjetit TAP”, propozuar nga TAP AG më datë 8 tetor 2025.

Gjithashtu në mbledhjen e datës 21.11.2025 Bordi i ERE-s pranoi kërkesën e paraqitur nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe filloi procedurën për shqyrtimin e planit 5 vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për periudhën rregullatore 2023 – 2027. Aplikimin për shqyrtimin e planit të sipërcituar e gjeni të publikuar në faqen e ERE-s në seksionin Publikime/Aplikime ose në linkun si më poshtë:

https://ere.gov.al/media/files/2025/11/27/OSSH_NR.2599_1_V_2025.pdf

BULETINI INFORMATIV

Fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë Alpex sh.a. për përcaktimin e tarifave të NEMO-s për vitin 2026.

Pas shqyrtimit të kërkesës së shoqërisë ALPEX sh.a. si dhe vlerësimeve të nevojshme, në mbledhjen e datës 21.11.2025, bordi i ERE-s vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë Alpex sh.a. për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Emëruar të Energjisë Elektrike (NEMO) për vitin 2026.

Ky njoftim gjendet i publikuar në faqen zyrtare të ERE-s, në të cilin ftohen të gjithë palët e interesuara të shprehin komentet dhe opinionet e tyre në lidhje me kërkesën e shoqërisë ALPEX sh.a. deri në datën 08.12.2025. (kliko [këtu](#))

Publikime dhe përditësime në webfaqe dhe në rrjetet sociale

Gjatë muajit nëntor është përditësuar informacioni në webin e ERE-s dhe rrjetet sociale me [vendime](#), [njoftime të mbledhjeve](#), njoftime mbi [aplikime të reja për licencim](#) si dhe [çmimet e shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për vitin 2025](#).

Gjithashtu, në webfaqen e ERE-s gjenden të rifreskuar regjistrat e mëposhtëm:

- Kërkesa dhe përgjigje në Programin e Transparencës ([kliko këtu](#))
- Ankesa të konsumatorëve ([kliko këtu](#))
- Licencime ([kliko këtu](#))
- Autorizime ([kliko këtu](#))
- Procedurat e autorizimit në proces ([kliko këtu](#))
- Procedurat e licencimit në proces ([kliko këtu](#))

Vendime për çmimet dhe tarifat

Në mbledhjen e datës 13.11.2025 Bordi i ERE-s miratoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin tetor 2025, në vlerën 16.60 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

Ky çmim rezulton më i lartë krahasuar me muajin shtator 2025, i cili ishte 14.76 lekë/kWh.

Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) është variabël dhe ndryshon nga muaji në muaj, si pasojë e ndryshimeve në koston e blerjes së energjisë në tregun e lirë për furnizimin e klientëve që marrin shërbimin në kushtet e mundësisë së fundit. Në këtë çmim, kostot e rrjetit dhe kostot administrative mbeten të pandryshuara, ndërsa komponenti kryesor që ndikon në luhatjen është kosto e energjisë së blerë.

Për muajin tetor 2025, kosto mesatare e blerjes së energjisë për mbulimin e kërkesës së klientëve të FMF-së ka rezultuar në vlerën 12.76 lekë/kWh, me një sasi të nominuar në bursën e energjisë prej 119.64 MWh. Ndërkohë, për muajin shtator 2025, kosto përkatëse ka rezultuar 10.97 lekë/kWh, me një sasi të nominuar prej 130.97 MWh. Në terma krahasues, kosto e blerjes së energjisë për muajin tetor është rritur rreth 16.3% në raport me muajin shtator, ndërsa sasia e energjisë së prokuruar për furnizimin e klientëve të lidhur në nivelin e tensionit 35kV është ulur rreth 8.7%.

Për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, të cilët furnizohen në kushtet e mundësisë së fundit, çmimi i shitjes së energjisë elektrike mbetet i pandryshuar në nivelin 18.26 lekë/kWh, siç është miratuar nga ERE në fillim të vitit 2025. Ky çmim mbetet fiks, pasi energjia për këtë kategori sigurohet nga KESH sh.a. me një kosto të qëndrueshme furnizimi. Në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe për të garantuar transparencë ndaj palëve të interesuara, ERE miraton dhe publikon periodikisht çmimin e llogaritur të shitjes së energjisë elektrike nga FMF, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

BULETINI INFORMATIV

NËNTOR

2025



Në kuadër të monitorimit të tregut të energjisë elektrike dhe informacionit të ardhur nga raportimet e të licencuarve sa i përket veprimatrive sipas kushteve të licencave përkatëse, më poshtë gjeni të dhënat më të fundit të përpunuara nga ERE gjatë muajit nëntor:

Sasia e energjisë së prodhuar deri në fund të muajit Tetor rezultoi në vlerën 5,569,527 MWh me një ulje prej rreth 12.5% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024, ndërsa sasia e energjisë së konsumuar u përlllogarit në vlerën 6,777,090 MWh duke rezultuar me një rritje konsumi prej rreth 2.5% për të njëjtën periudhë kohore.

Kapacitetit total prodhues të energjisë elektrike të instaluar në vendin tonë gjatë muajit Tetor i janë shtuar dy centrale hidrike respektivisht HEC-et e “Kaskadës Gjadër” të pozicionuar në zonën e Lezhës përgjatë rrjedhës së lumit Gjadër, me kapacitet të instaluar prej 25 MW të cilët operohen nga shoqëria “S.P.E GJADER” sh.p.k. dhe HEC “Faqekuq 3” me vendndodhje në zonën e Skraparit, Fshati Vlushë me kapacitet të instaluar prej 1.3 MW i cili operohet nga shoqëria “MER ENERGJI” sh.p.k. Gjithashtu kapacitetit prodhues i është shtuar edhe një central fotovoltaik i pozicionuar në zonën e Fierit, fshati Grykë me kapacitet të instaluar prej 2 MW në operim nga shoqëria “SOLAR HORIZON” sh.p.k. Të tre-ja shoqëritë e sipër përmendura zotërojnë kontrata shitblerje energjie me “FTL” sh.a. me çmim të rregulluar.

Për të njëjtën periudhë korresponduese kanë vijuar të dalin në treg të lirë 4 hece me një kapacitet total të instaluar prej 3,38 MW përkatësisht HEC-et “Dishnice”, “Corovode”, “Selca” dhe “Bene” shoqëritë respektive të së cilave kanë zotëruar kontrata shit-blerje energjie me “FTL” sh.a. Numri i hece-ve të cilat kanë dalë të treg të lirë deri në fund të muajit Tetor është 15 me kapacitet të instaluar 31,7 MW.

Humbjet e përgjithshme të sistemit të shpërndarjes për 10 mujorin e 2025 arrijnë në 16.36%, duke ruajtur trendin ulës me rreth 0,91% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024. Në sistemin e transmetimit për 10 mujorin e 2025 humbjet mbeten në vlerën 1.90 % me një diferencë prej 0,12% me pak për të njëjtën periudhë korresponduese.

Çmimi mesatar ditor klerues i bursës “ALPEX” sh.a për muajin Tetor ka qenë 126.80 €/MWh ndërkohë që volumet mesatare ditore janë përlllogaritur rreth 3,276 MWh. Për Zonën e Ofertimit të Shqipërisë, oferta në blerje për muajin tetor ishte 172,033.16 MWh, ndërkohë, oferta në shitje ka qenë 147,417.18. Për bashkimin e tregut Shqipëri - Kosovë, oferta në blerje për muajin Tetor ishte 312,119.00 MWh, ndërkohë oferta në shitje ka qenë 275,360.84 MWh.

Në përputhje me “Rregulloren për integritetin dhe transparencën e tregut me shumicë të energjisë (REMIT)”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 126, datë 17.05.2021 si dhe Ligjin nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, edhe gjatë muajve Tetor - Nëntor ERE ka vijuar me përditësimin e të dhënave mbi regjistrimin e pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike që hyjnë në transaksione me shumicë në Shqipëri (regjistri REMIT). Për periudhën kohore 11 mujore të vitit 2025 numri total i shoqërive të regjistruar në regjistër është 86. Përgjatë muajve Tetor - Nëntor janë regjistruar gjithsej 5 subjekte, respektivisht shoqëritë “GREEN VALUE” sh.p.k., “KAMENICA-HPP” sh.p.k., “ELEKTRO LUBONJA” sh.p.k., “OSOJA HPP” sh.p.k., dhe “Hidrocentrali QARR & KALTANJ” sh.p.k. Ky regjistër, gjendet i publikuar dhe i përditësuar në faqen e ERE-s në linkun <https://remit.ere.gov.al/>.

BULETINI INFORMATIV

NËNTOR

2025



Akte rregullatore të miratuara apo për të cilat janë filluar procedurat gjatë muajit nëntor.

“Strategjia e ERE për ndërgjegjësimin mbi kursimin e energjisë dhe përdorimin e burimeve alternative 2025–2030”, miratuar me vendimin nr. 299, datë 17.11.2025.

- ✓ “Udhëzuesi për mënyrën e pasqyrit të konsumit të energjisë elektrike në faturën mujore, identifikimin e ndarë të kategorive të konsumatorëve dhe zbatimin e cmimeve përkatëse” me vendimin e bordit të ERE-s nr. 294, datë 13.11.2025.
- ✓ “Rregullorja e Alokimit të Kapaciteteve Afatgjata”, miratuar me vendimin nr. 290, datë 13.11.2025.
- ✓ “Udhëzuesi për balancimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 291, datë 13.11.2025.
- ✓ “Metodologjia për vlerësimin e gatishmërisë së tregut shqiptar të energjisë elektrike të ditës në avancë”, miratuar me vendimin nr. 279, datë 06.11.2025.
- ✓ Me vendimin nr. 300 datë 17.11.2025 u vendos fillimi i procedurës për disa ndryshime në “Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017 e cila gjendet e publikuar në kategorinë konsultime nga data 21.11.2025 dhe për të cilën priten komente dhe opinione nga palët e interesit deri më datë 24.12.2025 (kliko [këtu](#)).
- ✓ Ka filluar procedura për miratimin e “Kodit të rrjetit mbi emergjencën dhe rivendosjen”, me vendimin nr. 292, datë 13.11.2025 i cili gjendet i publikuar për konsultim në faqen zyrtare të ERE-s nga data 17.11.2025 dhe priten komente dhe opinione nga palët e interesit deri më datë 19.12.2025 (kliko [këtu](#))

Ftojme të gjithë të interesuarit të vizitojnë faqen tonë zyrtare për të shfletuar të gjitha vendimet, raportet, cmimet dhe publikimet më të fundit www.ere.gov.al